



**VENDIM**

***Nr. 157, Datë 28.12.2015***

**MBI  
MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLAT E TREGUT  
SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 99; 109 dhe 110/2 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut, në lidhje me një ndryshim në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.06.2008, të ndryshuar,

**Konstatohet se :**

- ERE ka detyrimin e përshtatjes së kuadrit ligjor ekzistues me parashikimet e ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
- Organi i administratës në ushtrimin e funksioneve të tij, e në zbatim të ligjit, Nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, duhet të respektojë parimin e drejtësisë, barazisë dhe proporcionalitetit.
- Në nenin 99 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” parashikohet se “Çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike.”

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Miratimin e një ndryshimi në kapitullin IX.1.3 gërma “g” të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike me përmbajtjen si më poshtë :

*“Duke filluar nga 1 Janari 2016, çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike sipas legjislacionit në fuqi.”*

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a, KESH sh.a dhe OST sh.a, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**

**Petrit AHMETI**